

ALBPETROL SHA PATOS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 03.09.2021

Nga: "Albpetrol "sha – Patos

Drejtuar: "GENERAL BETON" shpk,

Adresa: Fier Patos PATOS Rruga Fier- Patos km.5, kthesa e Patosit, zona kadastrale me nr.2890,
nr.pasurie 59/14, kantier ndertimi perballe Alb Star.

NUIS K23013401A

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-03189-08-19-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Blerje çakell dhe stabilizant".

Kohezgjatja e kontrates është 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike: 23 Gusht 2021 nr.125

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "SARK" shpk me NUIS K52531415H, me vlerë oferte në total 4 710 000 lekë (pa TVSH).
2. Operatori ekonomik "GENERAL BETON" shpk me NUIS K23013401A, me vlerë oferte në total 5 040 000 lekë (pa TVSH).
3. Operatori ekonomik "ARDIT - 06" shpk me NUIS K63027403V, me vlerë oferte në total 5 264 000 lekë (pa TVSH).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik "SARK" shpk me NUIS K52531415H, për arsyet e mëposhtme:
- AK në Shtojcen Nr. 7 "KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT"
pika 1 gërma ç, ka kërkuar:
ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
Operatori Ekonomik nuk ka deklaruar emrat e anetareve që kanë fuqi përfaqësuese,

vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik të cilët nuk kanë qënë të dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së.

- AK në pikën 2.3.2 ka kërkuar: Flete analize të leshuar leshuar nga organet kompetente, jo më parë se 1 (një) muaj nga data e zhvillimit të kesaj procedure, për mallin objekt prokurimi (cakell dhe stabilizant).

Operatori Ekonomik ka paraqitur flete analize nga Subjekti “Shpiragu” shpk me të cilin nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktuale të paraqitur në sistem. Gjithashtu këto analiza mbajë datën 09.07.2019 në kundërshtim me parashikimin se këto Fletë Analiza duhet të jenë leshuar jo më parë se një muaj.

- AK në pikën 2.3.3 ka kërkuar: Nëse Ofertuesi nuk është prodhues, atëherë ai do të paraqesë, 1-Autorizim nga prodhuesi/perpunuesi ose kontratë bashkëpunimi e lidhur para noterit sipas të cilave prodhuesi/perpunuesi merr persiper të furnizojë ofertuesin me mallrat objekt prokurimi për gjithë kohegjatjen e kontrates....”

Operatori Ekonomik këto kontrata nuk i ka paraqitur në formën e kërkuar noteriale. Kontratat e paraqitura në sistem nuk janë lidhur para noterit por vetëm janë njehësuar me origjinalin para noterit.

- Pika 2.3.4 e DST, parashikon se:

Në pikën D/3 të shtojcës Nr.8, parashikohet se: Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Operatori Ekonomik ka deklaruar (JO) cka e perben kusht për skualifikim sipas LPP.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “GENERAL BETON” shpk me NUIS K23013401A me adresë Fier Patos PATOS Rruga Fier- Patos km.5, kthesa e Patosit, zona kadastrale me nr.2890, nr.pasurie 59/14, kantier ndertimi perballe Alb Star, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5 040 000 (pesë milion e dyzet mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Florjan MUCAJ